

VENDIM
Nr.46, datë 27.1.2006

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË KOMPANISË
TEATRORE SHTETËRORE TË ARTIT DRAMATIK (TEATRI KOMBËTAR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8578, datë 10.2.2000 “Për teatrin”, me propozimin e Ministrit të turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Kiço Londo, drejtor i Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar), lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Ndriçim Xhepa emërohet drejtor i Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).
3. Ngarkohet Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha